Ne pellgun e perroit Buzemadhes jane studiuar te gjitha nevojat e mundshme te perdorimit te ujit ne zone si ato aktuale edhe ato te perspektives duke dhene per shkallen e njedhjes vjetore e cila qendron ne kufjte e rekomandimeve Europiane (55 - 90) %.

### **3.1.6 Klima**

Zona e projektit dhe pellgu ujembledhes ne studim perfshihen kryesisht ne zonen klimatike mesdhetare malore lindore (IV b),e cila karakterizohet prej nje klime te ashper te ngjashme me nenzonen malore. Zona e projektit shfaq nje shkalle te larte kontinentaliteti dhe karakterizohet nga nje vere e freskët dhe dimër i ftohte.

Temperatura mesatare vjetore e pjeses se ulet te zones (me lartesi 1100 m -1300 m mbi nivelin e detit) eshte 7-10 ° C ,ndersa ne zonat mete lartaarrin deri 2-6 ° C.

Vlerat e temperaturave mini male absolute ndryshoj ne nga -10° C deri ne -15 ° C.Ne dimrat me te ftohte ,kjo vlere zbret deri ne -20 ° C.Megjithese rrallehere ne pika te caktuara temperaturat mund te zbresin deri ne vleren -30 ° C.Ne zonen e Bizes jane temperature lokale qe arrijne cleri ne -34.7 ° C.

Ne lartesi me te vogel,nunui I diteve me ngrice (me temperature me te vogel se 0 ° C) mund te arrij ne 120 -150 clite/vit.Ne lartesi me te meclha zgjatja e ngrices mund te arrije 120 -150 clit/vit.Ne larlesi mete meclha zgjatja e ngrices mund te arrije deri 180 clite.Janari eshte muaji me I ftohte dhe si pasoje ka nje temperature mesatare mete ulet : 2° C deri -3° C te ulta,-4° C deri -6° C ne lartesi me te meclha clhe me rrale deri -1 0° C ne pika te cakluara clhe ne kushte te vecanta.Nga fundi I muajit prill dhe fillimi I muajit tetor ,temperature mesatare eshte me e latte se 10° C me nje zgjatje kohore deri 6 muaj (maj-tetor).

Temperatura mesatare mujore te matura ne stacionin meteorologjik te Bushtrices dhe Peshkopise paraqiten ne figuren 2.Temperatura mesatare vjetore e Bushtrices eshte 8.6° C nclersa ne peshkopi I 0.8.Gradienti I temperatures ne kete zone eshte 0.6° C per cdo I 00111.

### ***Rreshjet atmosferike***

Sasia vjetore e reshjeve ne kete zone luhetet nga 1300 mm deri ne 18001111111.Ne shpatet percdimore ,clhe ne pika te caktuara,reshjet mund le kalojne vleren prej 2000 mm.Bora fillon ne fund te nentorit dhe vazhdon deri ne fillim te prillit.Numri I diteve me bore eshte rreth60-80 dite ne vit me me tepër se 90 dite ne pika te caktuara ,e ne disa zona vrojtohet nje shtrese e perhereshme bore. Pergjithesisht trashesia e bores eshte rreht 60-80 mm ne disa raste I kalon 2 m.

Reshjet mesatare mujore ne peshkopi,radomire dhe ne zall in e kalise jepern ne fig.3. Reshjet mesatare vjetore ne kete stacion arrin 950 111111.Sikurse shihet ne dy figurat ,reshjet me te rnedha vrojtohen ne muajt nentor dhe dhjetor.

Ne zonen e projektit ,burimi uJOR kryesore eshte Perroi I Fshatit,nje dege e lumit Caje ,Lumi I Fshatit buron ne nje lartesi 2000 -2100 m mbi ni velin e de tit dhe derdhet ne lumen Caje ne lartësinë 554 m mnd.Ne kete menyre ai zoteron nje potencial shfytezimi me nje renie prej 2000 m gjate rrjedhes se lumit.

## 3.2 Mjedisi biologjik

### 3.2.3 Flora

Gjatë vëzhgimit në terren u identifikuan 96 lloje bimësh. Tre lloje (*Juniperus communis*, *Prunus avium* dhe *Sambucus nigra*) bëjnë pjesë në Listën e Kuqe të Florës së Shqipërisë me statusin VU (Vulnerable). Familja më e zakonshme del të jetë Asteraceae me 14 lloje, ndjekur nga Rosaceae me 10 lloje, Fabaceae (9 lloje), Caryophyllaceae (6 lloje), Poaceae (6 lloje), Brassicaceae (5 lloje), Euphorbiaceae (4 lloje), Lamiaceae (4 lloje), etj.

Zona në fjalë i përket katit të ndërmjetëm të pyjeve gjetherënës dhe atyre halorë me lartësi mbidetare nga 1120 në 1335 m dhe kundrejtim jugperëndimor. Kemi të bëjmë me një policenozë (fitocenozë me një numër relativisht të lartë llojesh bimore).

### 3.2.5 Fauna

Gjatë studimit nuk u pa asnjë individ i gjitarëve të vegjël apo të mëdhenj. Lloje gjitarësh potencialisht të pranishëm përmendim: Lepurin (*Lepus europaeus*), Dhelprën (*Vulpes vulpes*), Ariun (*Ursus arctos*), Rrëqebullin e Ballkanit (*Lynx lynx balcanicus*), Miun e pyllit (*Apodemus sylvaticus*), Gjumashin e pyllit (*Dryomys nitedula*), Ketrin (*Sciurus vulgaris*), Iriqin gjoksbardhë verior (*Erinaceus roumanicus*), Urithin (*Talpa sp.*), Derrin e egër (*Sus scrofa*), Ujkun (*Canis lupus*), Lundërzën (*Lutra lutra*), Zardafin (*Martes martes*), Vjedullën (*Meles meles*), etj.

Sa i përket shpendëve, u identifikuan individë të llojeve: *Carduelis cannabina*, *Hirundo rustica*, *Motacilla alba*, *Parus major*, *Passer domesticus* dhe *Pica pica*. Asnjë prej këtyre llojeve nuk është i rrezikuar për zhdukje.

Habitatet e tilla me shkurre, pemë të larta breglumore dhe mjedise të thata të ekspozuara ndaj diellit përdoren kryesisht për ushqim nga lloje të gjinive *Aquila*, *Accipiter*, *Falco*, *Larus*, *Motacilla*, *Saxicola*, *Sylva*, *Lanius*, *Passer*, *Emberzia*, etj. Më konkretisht habitatet e tilla janë të favorshme për lloje si: Shqiponja e malit (*Aquila chrysaetos*), Shqiponja bishtvijezuar (*Aquila fasciata*), Huta (*Buteo buteo*), Gjeraqina kembshkurter (*Accipiter brevipes*), Krahethadra (*Falco peregrinus*), Thelleza e malit (*Alectoris graeca*), Pellumbi i eger i shkëmbit (*Columba livia*), Pupeza (*Upupa epops*), Dervishi (*Galerida cristata*), Dallendyshja e shkëmbit (*Ptyonoprogne rupestris*), Drenja e malit (*Anthus spinoletta*), Drenja e pyllit (*Anthus trivialis*), Bishttundesit i malit (*Motacilla cinerea*), Cerri (*Troglodytes troglodytes*), Mellenja e ujit (*Cinclus cinclus*), Dredhuesi gusheperhime (*Prunella modularis*), Dredhuesi alpin (*Prunella collaris*), Gushekuqi (*Erithacus rubecula*), Bilbili (*Luscinia megarhynchos*), Bishtkuqi zeshkan (*Phoenicurus ochruros*), Bishtbardha e gurit (*Oenanthe oenanthe*), Ceku kokezi (*Saxicola rubicola*), Bilbilthi kokezi (*Sylva atricapilla*), Trishtili i kalter (*Cyanistes caeruleus*), Zvarritesi i shkrepave (*Sitta neumayer*), Grifsha (*Garrulus glandarius*), Bengu (*Oriolus oriolus*), Harabeli i malit (*Passer montanus*), Cerla e malit (*Emberzia cia*).

## 3.3 Mjedisi socio-ekonomik

### 3.3.1 Profili i Bashkise Finiq

Referuar zones gjeografike Kukësi kufizohet në veri me Bashkinë Krumë, në perëndim me bashkitë Mirditë dhe Fushë-Arrëz, në jug me Bashkinë Dibër dhe në lindje me Republikën e Kosovës dhe me atë të Maqedonisë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Kukësit.



Figura 20: Ndarja administrative e bashkise Kukës

### 3.3.2 Demografia

Sipas Censurit të vitit 2011, popullsia është 47,985 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki ka 59,393 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 933.86 km<sup>2</sup> me një densitet prej 63.59 banorë/km<sup>2</sup> sipas Regjistrimit Civil dhe 51.38 banorë/km<sup>2</sup> sipas Censurit 2011.

Kjo bashki përbëhet nga 15 njësi administrative, të cilat janë: Kukësi, Malzi, Bicaç, Ujmisht, Tërthore, Shtiçen, Zapod, Shishtavec, Topojan, Bushtricë, Grykë-Çajë, Kalis, Surroj, Arrën dhe Kolsh. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit Kukës dhe pjesë e po këtij qarku. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 87 fshatra .

### 3.3.3 Ekonomia

Kukësi ishte një qendër industriale gjatë regjimit komunist në Shqipëri. Deri në vitet '90, Kukësi kishte industri të nxjerrjes dhe shkrirjes së bakrit (teknologji sovjetike e viteve '60), nxjerrjes dhe koncentrimit të mineralit të kromit, nxjerrjes së mineralit të kuarcit, prodhimit të materialeve të ndërtimit (materiale inerte, parafabrikate etj).

Ai njihet si një vend me traditë në rritjen dhe mbarështimin e deleve. Cilësia e mishit dhe e leshtit të deleve lumjane ishte e njohur në të gjithë Ballkanin. Kukësi ishte gjithashtu një qendër e njohur e transportit. Krahas llojeve të tjera të transportit, aty ishte i zhvilluar dhe transporti ujqor përmes liqenit artificial të Fierzës, i cili bënte të mundur lëvizjen e mallrave dhe të udhëtarëve si dhe zhvillimin e turizmit. Që prej vitit 2000, transporti përmes Liqenit të Fierzës ka pushuar së ekzistuari.

Një pjesë e konsiderueshme e banorëve të qytetit dhe të fshatrave punonin në zonën nxjerrëse dhe përpunuese të kromit në Kalimash si dhe në minierën e nxjerrjes së bakrit në Gjegjan. Transformimet e domosdoshme ekonomike drejt tregut të lirë pas viteve '90 bënë që pjesa më e madhe e industrisë së lartpërmendur të falimentojë tërësisht, sepse ajo industri ishte ngritur për të funksionuar në kushtet e një ekonomie të centralizuar. Mirëpo kjo shkaktoi shumë plagë sociale, duke krijuar një numër të madh të papunësh. Moszgjidhja në kohë e problemeve të pronësisë mbi tokën (veçmas problemeve të mbartura, të krijuara nga shpërngulja e detyrueshme e banorëve të Kukësit të Vjetër pas ndërtimit të HEC-it të Fierzës) shkaktuan shumë konflikte pronësie dhe bllokuan tërësisht nismat e biznesit vendas dhe atij të huaj, duke krijuar një ngërç absurd që ende sot e kësaj dite vazhdon të mbajë nën tension shumë prej banorëve të Kukësit.

## **Kapitulli 4 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT**

### **4.1 Metodika e aplikuar për vlerësimin ndikimeve në mjedis**

Veprimtaritë që zhvillohen në mjedis shoqërohen edhe me ndikimet ndaj tij që janë pjesë e pashmangshme e zhvillimit ekonomik dhe social. Megjithatë është e detyrueshme që, edhe në përputhje me procedurat ligjore, këto ndikime në mjedis të vlerësohen, diskutohen dhe të bëhen pjesë e procesit vendimmarrës. Gjithashtu është e rëndësishme që të bëhen përpjekje të arsyeshme dhe të mundshme që pasojat në mjedis të ndikimeve të jenë sa më minimale dhe në përputhje me normat ligjore në fuqi. Në këtë kontekst vlerësimi i ndikimeve të mundshme në mjedis si pasojë e zbatimit të projektit të propozuar është kryer duke u bazuar në natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur, mënyrën e funksionimit, sasinë e energjisë që do të prodhohet, lëndët e para të përdorura dhe mbetjet e gjenerura, të gjitha nën kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik. Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis është analizuar sipas fazave të veprimtarisë si më poshtë:

- Në fazën përgatitore/instalimeve/ndërtimit të veprave inxhinierike;
- Në fazën e funksionimit të hidrocentralet dhe prodhimit të energjisë elektrike.

Me këtë përqasje do të paraqiten e trajtohen në vijim ndikimet e parashikuara si dhe masat që propozohen për minimizimin e pasojave të tyre në mjedis dhe mbrojtjen e mjedisit. Analiza e ndikimeve është treguar në paragrafët e mëposhtëm në mënyrë tabelare ku, në planin vertikal renditen operacionet/aktivitetet (ndërtimore ose operacionale) të projektit, në atë horizontal receptorët e ndikimit të tyre në mjedis, ndërsa në pikëprerjen e tyre jepen sqarime për mënyrën e ndikimit dhe pasojën e mundshme të tij në receptor të tilla si përgatitja e trasesë së tubacionit – dëmtimi i habitatit natyror etj.

### **4.2 Identifikimi i ndikimeve në fazën e përgatitjes dhe ndërtimit të veprave inxhinierike**

Për një analizë sa më objektive të ndikimeve të mundshme në mjedis, fillimisht janë përcaktuar të gjithë aktivitetet/operacionet të cilat si pasojë e zhvillimit të ciklit të tyre mund të bëhen shkak për ndikime. Operacionet kryesore me ndikime të mundshme në mjedis në fazën e ndërtimit të veprës janë:

- Ndërtimi i komponentëve inxhinierikë ku përfshihen: veprat e marrjes; dekantuesi; kanali i derivacionit, baseni i presionit dhe tubacioni i turbinave.
- Ndërtimi i kanaleve të derivacionit dhe tubacioni i turbinave.

#### **4.2.1 Matrica e ndikimeve të mundshme negative të operacioneve ndërtimore në receptorët e mjedisit**

Operacioni	Receptorët e mjedisit					
	Biodiversitet (fauna & flora)	Tokë & prodhimi i mbetjeve	Ujëra	Ajër	Zona të mbrojtura	Zona urbane & shëndetin e njeriut
<p><b>Ndërtimi i komponentëve inxhinierikë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• veper marrjeje</li> <li>• derivacioni ujit</li> <li>• dekantues</li> <li>• basen presioni</li> <li>• tubacioni i presionit</li> </ul> <p>Të gjithë këta komponentë karakterizohen nga të njëjtat operacione ndërtimore përfshirë gjermim toke, sheshim-stabilizim sheshi, ndërtim. Për rrjedhojë shfaqin të njëjtat ndikime në mjedisin pritës.</p>	<p>Dëmtim i vegjetacionit në zonat ku do të ndërtohen veprat e marrjes, transportuesit e ujit pa presion, dekantuesi, baseni i presionit dhe tubacioni i presionit.</p> <p>Shqetësim i habitatit të brigjeve të lumit në sektorët ku do të ndërtohen komponentet e vepres.</p> <p>Aksidente të mundshme të zvarranikëve dhe amfibëve si pasojë e gjermimeve dhe qarkullimit të makinerive.</p> <p>Largim i përkohshëm i faunës nga zona e ndikimit të punimeve.</p>	<p>Ndryshim në destinacionin e përdorimit të tokës</p> <p>Erozion i mundshëm i brigjeve për shkak të operacioneve të gjermimit.</p> <p>Ndotje me hidrokarbure dhe lubrifikantë si pasojë e avarive të makinerive të gjermimit.</p> <p>Prodhimi i mbetjeve inerte (shkëmb, dhera).</p> <p>Sasia totale e dherave që do të gjenerohen do të jete Dhe dhe shkemb</p> <p>Materiale shkemb dhe dhe të nevojshme për mbushje</p> <p>Sasia e materialit mbushës do të sigurohet nga materiali shkemb në terren i cili do të thyhet në vend.</p>	<p>Shtim i mundshëm i sedimenteve dhe llumrave në rrjedhën e lumit si pasojë e operacioneve ndërtimore dhe e erozionit në zonat e ndërtimit (në kohë me reshje të forta).</p> <p>Ndotje me hidrokarbure dhe lubrifikantë si pasojë e avarive të makinerive të gjermimit.</p>	<p>Shkarkimet të standarte të gazeve, grimcave të pluhurit dhe zhurmës nga makineritë e ndërtimit.</p> <p>Ndikim minimal në mjedis.</p>	<p>Projekti për ndërtimin e HEC KULOTES shtrihet brenda zonës së mbrojtur Korab Koritnik, shpallur me VKM NR. 898, datë 21.12.2011, kategoria e IV e zonave të mbrojtura.</p> <p>Sipas zonimit të brendshëm dhe planit të menaxhimit, sipërfaqja (zona) për zhvillimin e veprimtarisë "Projekt zbatimi", ndodhet në zonën e përdorimit tradicional (ZPT). Në pellgun ujor të këtij perroi (në pjesën e sipërme të tij), ekziston Hec Terfoja, ndërtuar vite më parë dhe nuk ka sjell ndikime negative në mjedis, ndërkohë është hapur dhe traseja e rrugës që shërben për këto hec duke ulur mundësinë e ndikimit në zonë.</p>	<p>Të gjithë këta komponentë do të ndërtohen të distancuara nga qendrat e banuara. Për rrjedhojë këto të fundit nuk do të ndikohen nga punimet por banorët e zonave pranë të cilave kalon rruga mund të shqetësohet nga operacionet e shtuara të transportit. Do të ketë emetim zhurmash dhe pluhurash për shkak të automjeteve të transportit që do të përdoren në ndërtim. Rrezik për bimesinë breglumore dhe ndikim në erozion</p> <p>Rrezik i ulët për aksidente.</p>



<p><b>Instalimi në shtratin e lumit i derivacionit</b></p> <p><u>Derivacionet ose tranportieret i ujit</u></p> <p>Derivacioni nga vepra e Marrjes deri te puseta e bashkimit.</p> <p>Derivacioni nga puseta e bashkimit deri te dekantuesi.</p>	<p>Shqetësim i habitatit dhe bimësisë natyrore në sipërfaqen e traseve ku do të shtrihen tubacionet e derivacioneve.</p> <p>E gjithë kjo sipërfaqe e ndikuar është prone e Basenit Ujor dhe përfshihet në fond pyjor.</p> <p>Aksidente të mundshme të zvarranikëve dhe amfibëve si pasojë e gërmimeve dhe qarkullimit të makinerive.</p> <p>Largim i përkohshëm i faunës nga zona e ndikimit të punimeve.</p>	<p>Do të ndikohet një sipërfaqe toke nga instalimi i tubave të derivacionit.</p> <p>Sasi e gjeneruar dherash dhe mbetje inerte (shkemb) nga punimet e te gjithë vepres. Sasia me e madhe e dherave dhe shkembit do te gjenerohet nga tubacioni i derivacionit.</p> <p>Erozion dhe dëmtim i strukturës së tokës (shkembit tokeformues) në sipërfaqet e trasesë.</p> <p>Ndotje me hidrokarbure dhe lubrifikantë si pasojë e avarive të makinerive të gërmimit.</p>	<p>Ndotje me hidrokarbure dhe lubrifikantë si pasojë e avarive të makinerive të gërmimit.</p>	<p>Shkarkimet standarte të gazeve, grimcave të pluhurit dhe zhurmës nga makineritë e ndërtimit.</p>	<p>Projekti per ndertimin e HEC KULOTES shtrihet brenda zones se mbrojtur Korab Koritnik, shpallur me VKM NR. 898, date 21.12.2011, kategoria e IV e zonave te mbrojtura.</p>	<p>Derivacioni presion do të ndërtohet i distancuar nga qendrat e banuara. Për rrjedhojë këto të fundit nuk do të ndikohen nga punimet.</p> <p>Ndertimi i tubacionit te derivacionit do te kerkoje punime te qe do te kryhen prane rrjedhes se ujrave duke ndikuar perkohesisht cilesine e ujrave siperfaqesore.</p> <p>Rrezik per erozion pasi do te kete ndikim edhe ne bimesine breglumore.</p>
---	---	--	---	---	---	--


<p><b><i>Tubacionet e Turbinave</i></b></p> <p><u>Tubacioni i HEC</u></p>	<p>Sipërfaqja me vegjetacion që pritet të ndikohet nga instalimi i tubacioneve të turbinave i cili do të ndertohen ne shtratin e lumit, dhe ne shtratin anesor paraqitet e ndjeshme nga pikpamja e biodiversitetit sepse shtrihet përgjatë shtratit të lumit në habitatin breglumor.</p> <p>Aksidente të mundshme të zvarranikëve dhe amfibëve si pasojë e gërmimeve dhe qarkullimit të makinerive.</p> <p>Largim i përkohshëm i faunës nga zona e ndikimit të punimeve.</p>	<p>Do të ndikohet një sipërfaqe toke dhe shkemb nga instalimi i tubave të turbinave.</p> <p>Erozion dhe dëmtim i strukturës së tokës nga gërmimet.</p> <p>Ndotje me hidrokarbure dhe lubrifikantë si pasojë e avarive të makinerive të gërmimit.</p> <p>Sasi minimale dherash, shkemb dhe mbetje inerte nga përgatitja e traseve të tubacioneve.</p>	<p>Shtim i sedimenteve dhe llumrave në rrjedhën e lumit nëse mbetjet e gërmimit nuk sistemohen.</p> <p>Ndotje me hidrokarbure dhe lubrifikantë si pasojë e avarive të makinerive të gërmimit.</p>	<p>Shkarkimet standarte të gazeve, grimcave të pluhurit dhe zhurmës nga makineritë e ndërtimit. Ndikim minimal në mjedis.</p>	<p>Projekti per ndertimin e HEC KULOTES shtrihet brenda zones se mbrojtur Korab Koritnik, shpallur me VKM NR. 898, date 21.12.2011, kategoria e IV e zonave te mbrojtura.</p>	<p>Tubacioni me presion do të vendosen ne pjesen anesore te shtratit te lumit, të distancuara nga qendrat e banuara. Për rrjedhojë këto të fundit nuk do të ndikohen nga punimet, por banorët e zonave pranë të cilave kalon rruga mund të shqetësohet nga operacionet e shtuara të transportit. Do të ketë emetim zhurmash dhe pluhurash për shkak të automjeteve të transportit që do të përdoren në ndërtim.</p> <p>Rrezik i ulët për aksidente.</p>
---	--	--	---	---	---	---

### 4.2.3 Zhurmat dhe gazet në mjedis të makinerive të ndërtimit dhe zonat e ndjeshme

Sa lidhet me emetimin e zhurmave gjatë fazës ndërtimore, duhet theksuar se ky ndikim është i përkohshëm dhe fare minimal duke marrë në konsideratë zonën ku do të kryhen punimet. Së pari faza e ndërtimit është një fazë e mirëpërcaktuar në kohë dhe së dyti operacionet e ndërtimit do të kryhen brenda orareve të zakonshëm të punës. Bazuar edhe në referencat ndërkombëtare për projekte të ngjashme vlerësohet se zhurmat teknologjike nga mjetet e rënda e japin efektin e tyre kumulativ deri në një rreze prej 150- 200 m, në varësi edhe të konfiguracionit natyror të terrenit, i cili shërben si barrierë natyrale etj. Në tabelën më poshtë jepen vlerat referencë të Agjencisë Amerikane të Mjedisit për nivelet e çlirimit në mjedis të zhurmës nga makineritë e ndërtimit.

Nga ana tjetër, zona ku do të kryhen operacionet ndërtimore gjendet larg qendrave të banuara si edhe pergjate rruges nacionale. Për sigurinë dhe uljen e shqetësimit do të merren masa gjatë qarkullimit dhe operacioneve të transportit. Duhet theksuar, se meqenës bëhet fjalë për zonë rurale, nivelet bazë të zhurmës janë të ulëta për shkak të zhvillimit të pakët ekonomik dhe cilësia e ajrit është e kënaqshme. Në këto kushte, ka kapacitete përthithës dhe ndikimi do të jetë minimal.

Masat që rekomandohen për menaxhimin mjedisor të makinerive të ndërtimit jepen në Seksionin e mëposhtëm (Plani i Menaxhimi të Mjedisit).



### **4.3 Identifikimi i ndikimeve në mjedis gjatë fazës së shfrytëzimit të veprës dhe prodhimit të energjisë elektrike**

Ndikimi kryesor në fazën e prodhimit të energjisë elektrike është pakësimi i ujit të perroit, i cili shoqërohet me ndikime në habitatet e tij, qoftë ai i brigjeve ashtu edhe në llojet e iktiofaunës. Skema e shfrytëzimit parashikon ndërtimin e derivacionit për HEC KULOTA, dhe tubacioneve të turbinave.

Pra, rrjedha e lumit, për shkak të ndërtimit të derivacioneve dhe tubacioneve do të ndikohet në një segment të saj.

#### 4.3.1 Matrica e ndikimeve të mundshme negative të fazës operacionale në receptorët e mjedisit

Operacioni	Receptorët e mjedisit					
	Biodiversitet (fauna & flora)	Tokë & prodhimi i mbetjeve	Ujëra	Ajër	Zona të mbrojtura	Ndikime në komunitet
Prodhimi i energjise elektrike	Ndikimi do të ketë pasoja në habitatin e brigjeve të lumit në segmentet nga veprat e marrjes deri në shkarkimin e ujit nga centrali.	S'ka	Zvogëlimi i sasisë së ujërave në nje segment te lumit.	S'ka	Projekti per ndertimin e HEC KULOTES shtrihet brenda zones se mbrojtur Korab Koritnik, shpallur me VKM NR. 898, date 21.12.2011, kategoria e IV e zonave te mbrojtura.	<p>Pakësimi i sasisë së ujit të lumit mund të shkaktojë probleme me ujitjen e tokave bujqësore në zonë, veçanërisht në sezonin e thatë. Për këtë arsye, projekti parashikon që gjatë kësaj periudhe HEC-i të mos punojnë nese do te jete e nevojshme.</p> <p>Veprat e marrjes se bashku em tubacionin e derivacionit ndodhen ne pjesen e poshtme te relievit dhe poshte tokave te bukes (toka bujqesore) .Uji per vaditje ne keto toka kryhet me ngritje nga perroi.</p>

## **Kapitulli 5            PLANI I MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE**

Për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis të identifikuar në seksionin paraardhës, kompania do të zbatojë një plan masash zbutëse i cili ka për qëllim parandalimin ose minimizimin e ndotjes dhe dëmtimit të mjedisit si dhe shëndetin e sigurinë në punë. Plani i masave synon respektimin e standardeve mjedisore gjatë kryerjes së aktiviteteve ndërtuese të HEC-eve dhe më pas shfrytëzimit të tij, në mënyrë të sigurt dhe efektive, me qëllim final mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit. Konkretisht, ai fokusohet në ndikimet e identifikuar në mjedis në fazat e ndërtimit dhe të shfrytëzimit të veprës, masat përkatëse mënjanuese ose minimizuese dhe institucionet përgjegjëse.

### **5.1    Plani i masave të nevojshme për zbutjen e ndikimeve**

Masat kryesore të propozuara adresojnë zgjidhje të mundshme dhe të përshtatshme për minimizimin e ndikimeve negative në mjedis të identifikuar gjatë VNM. Këto masa duhet të synojnë:

- Rehabilitimin e sipërfaqeve që do të përdoren dhe ndikohen nga veprimtaria ndërtimore.
- Minimizimin e dëmtimeve të biodiversitetit (vegjetacionit dhe habitatit).
- Sistemimin e masës inerte që do të dalë nga; përdorimin e një pjese të tyre në mbushje (në ndërtimin e komponentëve të HEC).
- Kontrollin e erozionit.
- Lëshimin e prurjeve ekologjike dhe programimin e lëshimit përgjatë rrjedhës ekzistuese.

Zbatimi me korrektësi i këtyre masave do të bëhet i mundur nga përdorimi i teknikave të mëposhtme:

- Piketimi i saktë i sipërfaqes së ndërtimit dhe kufizimi i veprimtarisë vetëm brenda saj.
- Kontrolli i dherave të gjeneruara dhe sistemimi i tyre nëpërmjet kompaktësimit.
- Sistemimin e nevojshëm për drejtimin e ujrave të shiut me qëllim zvogëlimin e erozionit.
- Kontrolli i pluhurave nëpërmjet lagies së zonës së punës dhe mbulimit të makinerive gjatë transportit.
- Kontrolli teknik i mjeteve të punës për të parandaluar rrjedhjet e karburantit.

## 5.2 Plani i masave për zbutjen e ndikimeve negative dhe mbrojtjen e mjedisit në fazën e ndërtimit

Operacioni në mjedis	Ndikimi i identifikuar	Receptori mjedisor	Masat e propozuara për zbutjen dhe kontrollin e ndikimeve
<b>Biodiversitet</b>			
Ndërtimi i komponentëve inxhinierikë (veprat e marrjes, derivacionet ose transportuesit e ujit, dekantues, basen presioni dhe tubacioni i turbinave /tubacioni i presionit)	Dëmtim i vegjetacionit në zonat ku do të ndërtohen veprat inxhinierike. Shqetësim i habitatit të brigjeve të lumit.	Flora	Për të mbajtur ndikimin në kufijtë e projektuar, përpara fillimit të gërmimit dhe ndërtimit të veprave inxhinierike, duhet të kryhet punë rievuese dhe të piketohet saktë sipërfaqet e punimeve.  Kufizimi i punimeve brenda sipërfaqeve të nevojshme
	Prerje pemesh	Drure pyjor	Për të mbajtur ndikimin në kufijtë e projektuar, përpara fillimit të gërmimit dhe ndërtimit të veprave inxhinierike, duhet të shenohet sakte gjurma e vepres dhe gjurma e aksesit. Nga Bashkia të mbahet një proces verbal për shpyllezimin e pemëve nëse do të ketë të tilla.  Subjekti për çdo pemë të prerë do të mbjellë 3 fidane të rinje përgjate gjithë gjurmës së projektit.  Për zhvillimin e këtyre komponenteve të vepres preken ngastera pyjore për të cilat do të lidhet kontrate qeraje me Bashkinë.
	Shqetësim/dëmtim i mundshëm i faunës ujore dhe asaj të lidhur ngushtësisht me të (amfibë) në shtratin e lumit	Fauna	Inspektimi para fillimit të operacioneve për të analizuar me kujdes sjelljet e botës së gjallë në zonën e punimeve dhe evidentimin e masave me specifike për ruajtjen e saj. Një observim i detajuar me cikël të plotë kohor rekomandohet për të inventarizuar më tej llojet target të faunës.  Hartimi i një plani të posaçëm trajnimi dhe udhëzimesh për t'u zbatuar nga stafi i zbatimit të punimeve. Trajnimet dhe udhëzimet specifike duhet të realizohen përpara fillimit të punimeve në terren.  Parandalimi i ndotjes së rrjedhës së lumit gjatë punimeve për ndërtimin e veprave inxhinierike. Substancat me pasoja në faunën akuatike dhe premisa për ndotje duhet të evidentohen dhe punëtorëve u duhen dhënë udhëzimet paraprake për ruajtjen dhe përdorimin e tyre.
	Aksidente të mundshme të zvarranikëve dhe amfibëve si pasojë e gërmimeve dhe qarkullimit të makinerive.	Fauna	Gjatë operacioneve të transportit dhe ndërtimit të veprave të HEC KULOTA mund të ndodhin aksidente të tilla si shtypja dhe vrasja e zvarranikëve dhe amfibëve në zonë. Për këtë do të instruktohen punëtorët dhe kontraktorët të tregojnë kujdesin e duhur dhe lëvizja e mjeteve të

			<p>bëhet me shpejtësi të ulët me qëllim që terreni të shihet qartë dhe të krijohet mundësia e shmangies së përplasjes së kafshëve të egra.</p> <p>Vendosja e tabelave sinjalizuese do të konsiderohet nëse gjatë inspektimit në terren rezultojnë kalime të shpeshta të zvarranikëve apo amfibëve përgjatë zonës së projektit (përgjatë rrugëve etj).</p>
	Largim i përkohshëm i faunës nga zona e ndikimit të punimeve.	Fauna	<p>Masa më e përshtatshme për të adresuar këtë ndikim vlerësohet minimizimi i kohës së operacioneve në terren dhe largimi sa më i shpejtë i mjeteve të rënda që gjenerojnë zhurmë dhe shqetësim për faunën e egër. Ideale do të ishte sikur në stinën e pranverës (muajt mars - qershor) të kufizoheshin operacionet më shqetësuese për faunën për t'i dhënë mundësinë e riprodhimit të saj në zonën e projektit.</p>
Instalimi i tubacionit të derivacionit	Shqetësim i habitatit dhe bimësisë natyrore në sipërfaqen e derivacionit të ujit.	Bimësia/ habitati	<p>Për të mbajtur ndikimin në kufijtë e projektuar, përpara fillimit të gërmimit dhe ndërtimit të veprave të derivacionit, duhet të kryhet punë rilevuese dhe të piketohet saktë sipërfaqet e punimeve.</p> <p>Të mbahen evidenca të sakta gjatë punës në terren sidomos nëse del e nevojshme prerja e ndonjë druri pyjor.</p>
	Aksidente të mundshme të zvarranikëve dhe amfibëve si pasojë e gërmimeve dhe qarkullimit të makinerive.	Fauna	<p>Gjatë operacioneve të transportit dhe ndërtimit mund të ndodhin aksidete të tilla si shtypja dhe vrasja e zvarranikëve dhe amfibëve në zonë. Për këtë do të instruktohen punëtorët dhe kontraktorët të tregojnë kujdesin e duhur dhe lëvizja e mjeteve të bëhet me shpejtësi të ulët me qëllim që terreni të shihet qartë dhe të krijohet mundësia e shmangies së përplasjes së kafshëve të egra.</p> <p>Vendosja e tabelave sinjalizuese do të konsiderohet nëse gjatë inspektimit në terren rezultojnë kalime të shpeshta të zvarranikëve apo amfibëve përgjatë zonës së projektit (përgjatë rrugëve etj).</p>
	Largim i përkohshëm i faunës nga zona e ndikimit të punimeve.	Fauna	<p>Masa më e përshtatshme për të adresuar këtë ndikim vlerësohet minimizimi i kohës së operacioneve në terren dhe largimi sa më i shpejtë i mjeteve të rënda që gjenerojnë zhurmë dhe shqetësim për faunën e egër. Ideale do të ishte sikur në stinën e shumimit masiv (muajt mars- qershor) të kufizoheshin operacionet më shqetësuese për faunën për t'i dhënë mundësinë e riprodhimit të saj në zonën e projektit.</p>



Tubacioni i presionit	Sipërfaqja e tubacionit të presionit do të ndertohen pergjate shtratit te lumit por punimet per ndertimin / vendosjen e ketij tubacioni do te krijoje shqetesime ne faunen perreth	habitati	Për të shmangur demtimet e panevojshme ne vegjetacion, përpara fillimit të gërmimit dhe ndërtimit të trasese, duhet të kryhet punë rievuese dhe të piketohet saktë sipërfaqet e punimeve. Duhet të shmangur aksesit ne zona te papaketuara dhe jashte projektit sikurse makinerite te levizin brenda trupit te perroit duke patur parasysh te mos demtojne brigjet e kesaj vije ujore .
	Aksidente të mundshme të zvarranikëve dhe amfibëve si pasojë e gërmimeve dhe qarkullimit të makinerive.	Fauna	Gjatë operacioneve të transportit dhe ndërtimit mund të ndodhin aksidente të tilla si shtypja dhe vrasja e zvarranikëve dhe amfibëve në zonë. Për këtë do të instruktohen punëtorët dhe kontraktorët të tregojnë kujdesin e duhur dhe lëvizja e mjeteve të bëhet me shpejtësi të ulët me qëllim që terreni të shihet qartë dhe të krijohet mundësia e shmangies së përplasjes së kafshëve të egra.  Vendosja e tabelave sinjalizuese do të konsiderohet nëse gjatë inspektimit në terren rezultojnë kalime të shpeshta të zvarranikëve apo amfibëve përgjatë zonës së projektit (përgjatë rrugëve etj).
	Largim i përkohshëm i faunës nga zona e ndikimit të punimeve.	Fauna	Masa më e përshtatshme për të adresuar këtë ndikim vlerësohet minimizimi i kohës së operacioneve në terren dhe largimi sa më i shpejtë i mjeteve të rënda që gjenerojnë zhurmë dhe shqetësim për faunën e egër. Ideale do të ishte sikur në stinën e shumimit masiv (muajt mars- qershor) të kufizoheshin operacionet më shqetësuese për faunën për t'i dhënë mundësinë e riprodhimit të saj në zonën e projektit.
<b><i>Tokë</i></b>			
Ndërtimi i komponentëve inxhinierikë (veprat e marrjes, derivacionet ose transportuesit e ujit, dekantues, basen presioni dhe tubacioni i turbinave /tubacioni i presionit)	Prodhimi i mbetjeve inerte (shkëmb, dhera dhe vegjetacion).		Gërmimi duhet të kryhet vetëm në sipërfaqet e projektuara ne periudha qe nuk ka uje dhe në mot të thatë.  Sipërfaqet e gërmuara dhe me pjerrësi toke mbi 20% duhet të mbulohen me fibra plastike në mot me reshje intensive dhe të zgjatura në kohë.
	Erozion dhe dëmtim i strukturës së tokës.		Në kuotat e sipërme të zonës së gërmimeve duhet të hapen kanale për devijimin e ujërave të shiut nga sipërfaqet e gërmuara.  Mbetjet e ndërtimit duhet të sistemohen dhe depozitohen në mënyrë të sigurtë ose të riperdoren per mure mbajtese etj
	Ndotje me hidrokarbure dhe lubrifikantë si pasojë e avarive të makinerive të gërmimit.		Mjetet e ndërtimit duhet të kontrollohen periodikisht për gjendjen teknike me qëllim që të shmangen avaritë me pasoja si rrjedhja e hidrokarbureve në tokë.  Mjetet e pastrimit të tokës në rast të ndotjes me hidrokarbure duhet të jenë të pranishme në kantierin e punimeve.

		Në rast të ndotjes aksidentale të tokës, duhet të hiqet dhe i ndotur dhe të ruhet në kontenerë të izoluar për t'u trajtuar më pas në vendin dhe mënyrën e përshtatshme.
Instalimi i derivacionit	Erozion dhe dëmtim i strukturës së tokës.	Hapësirat midis tokës, bazamentit dhe strukturave inxhinierike duhet të mbushen me zhavorr dhe lëndë të përshtatshme për të krijuar lidhjen e tyre dhe evituar shembjen e tokës nga gërryerjet e ujërave të reshjeve. Siperfaqja e strukture se tokes e pakthyeshem do te jete relativisht e vogel.
	Ndotje me hidrokarbure dhe lubrifikantë si pasojë e avarive të makinerive të gërmimit.	Mjetet e ndërtimit duhet të kontrollohen periodikisht për gjendjen teknike me qëllim që të shmangen avaritë me pasoja si rrjedhja e hidrokarbureve në tokë. Mjetet e pastrimit të tokës në rast të ndotjes me hidrokarbure duhet të jenë të pranishme në kantierin e punimeve. Në rast të ndotjes aksidentale të tokës, duhet të hiqet dhe i ndotur dhe të ruhet në kontenerë të izoluar për t'u trajtuar më pas në vendin dhe mënyrën e përshtatshme.
	Gjenerimi i mbetjeve inerte.	Sasia e materialit per mbushje eshte parashikuar te jete 1,5 here me e madhe se sasia e materialit te germuar .Një pjesë e këtyre mbetjeve do të mund të përdoren në mbushje dhe ndertim skarpatesh . Mbetjet që nuk mund të ripërdoren për nevoja të ndërtimit do të depozitohen në vende të përshtatshme për të cilat do të bëhet marrëveshje me pushtetin vendor. Një plan i detajuar i administrimit të mbetjeve do të hartohet përpara fillimit të punimeve në terren. Plani do të njihet nga nënkontraktorët dhe ata do të udhëzohen për menaxhimin e sigurte të mbetjeve.
Tubacioni i turbinave	Erozion dhe dëmtim i strukturës së tokës në sipërfaqen e trasesë së tubacionit.	Gërmimi duhet të kryhet vetëm në sipërfaqen e projektuar. Gërmimi duhet të realizohet në mot të thatë. Sipërfaqet e gërmuara dhe me pjerrësi toke mbi 20% duhet të mbulohet me fibra plastike në mot me reshje intensive dhe të zgjatura në kohë. Sistemimi në vendin përkatës i materialeve të gërmimeve (duke qenë se tubacioni do të vendoset mbi sipërfaqen e tokës, ky volum do të jetë i papërfillshëm).

	Ndotje me hidrokarbure dhe lubrifikantë si pasojë e avarive të makinerive të gërmimit	<p>Mjetet e ndërtimit duhet të kontrollohen periodikisht për gjendjen teknike me qëllim që të shmangen avaritë me pasoja si rrjedhja e hidrokarbureve në tokë.</p> <p>Mjetet e pastrimit të tokës në rast të ndotjes me hidrokarbure duhet të jenë të pranishme në kantierin e punimeve.</p> <p>Në rast të ndotjes aksidentale të tokës, duhet të hiqet dhe i ndotur dhe të ruhet në kontenerë të izoluar për t'u trajtuar më pas në vendin dhe mënyrën e përshtatshme.</p>
<b>Ujëra</b>		
Ndërtimi i komponentëve inxhinierikë (veprat e marrjes, derivacionet ose transportuesit e ujit, dekantues, basen presioni dhe tubacioni i turbinave /tubacioni i presionit)	Shtim i mundshëm i sedimenteve dhe llumrave në rrjedhën e përroit si pasojë e punimeve (gërmime, erozion).	<p>Përsheptim i punimeve (evitimi i zgjatjes së paarsyeshme të punimeve, planifikim dhe kapacitete).</p> <p>Punimet duhet të bëhen në mot të thatë.</p> <p>Llumi i gërmimeve duhet të evitohet nga kontakti me përroit.</p> <p>Dherat dhe llumrat duhet të sistemohen dhe të mos lejohet të rrëshqasin në rrjedhën e perrenjeve.</p> <p>Pjesa më e madhe e materialit shkembor të gërmimit të riperdoret për mbulim dhe sistemim brigjesh të perrenjeve.</p>
	Ndotje me hidrokarbure dhe lubrifikantë si pasojë e avarive të makinerive të gërmimit.	Mjetet e ndërtimit duhet të kontrollohen periodikisht për gjendjen teknike me qëllim që të shmangen avaritë me pasoja si rrjedhja e hidrokarbureve në mjedis.
Ndërtimi i tubacionit të turbinave / tubacionit të presionit	Shtim i mundshëm i sedimenteve dhe llumrave në rrjedhën e lumit si pasojë e punimeve (gërmime, erozion).	<p>Përsheptim i punimeve në shtratin e lumit (evitimi i zgjatjes së paarsyeshme të punimeve, planifikim dhe kapacitete).</p> <p>Punimet duhet të bëhen në mot të thatë.</p> <p>Llumi i gërmimeve duhet të evitohet nga kontakti me rrjedhën e përroit.</p> <p>Dherat dhe llumrat duhet të sistemohen dhe të mos lejohet të rrëshqasin në rrjedhën e lumit.</p>
	Ndotje me hidrokarbure dhe lubrifikantë si pasojë e avarive të makinerive të gërmimit.	Mjetet e ndërtimit duhet të kontrollohen periodikisht për gjendjen teknike me qëllim që të shmangen avaritë me pasoja si rrjedhja e hidrokarbureve në mjedis.
<b>Ajër</b>		
Të gjitha operacionet	Shkarkimet standarte të gazeve, grimcave të pluhurit dhe zhurmës nga makineritë e ndërtimit.	<p>Mjetet duhet të jenë certifikuar për gjendjen teknike nga SGS Albania. Kontroll dhe mirëmbajtje në gjendje të mirë teknike të mjeteve të punës.</p> <p>Përdorim i lëndëve djegëse cilësore për motorët.</p>

		<p>Transporti i materialeve të ndërtimit duhet të bëhet me kamionë me karroceri të mbuluar .</p> <p>Në zonat e banuara shpejtësia e automjeteve duhet të kufizohet në 30 km/orë.</p> <p>Duhet të evitohet përdorimi i borive nëpër zonat e banuara.</p>
--	--	---

### 5.3 Masat për të zbutur ndikimet në mjedis gjatë fazës së funksionimit të HEC-it

Veprimet	Receptori i ndikuar	Masat e rekomanduara
Devijimi i ujit për prodhim energjie	Devijimi i ujërave do të afektojë habitatin e brigjeve të perrenjve në segmentin nga vepra e marrjes deri në shkarkimin e ujit nga centrali.	<p>Ky është një nga ndikimet kryesore të hidrocentralit. Segmenti i devijimit të ujërave të perroit është dhe për zbutjen e këtij ndikimi rekomandohet që të respektohen mënyrat rregulluese të ujit për të ruajtur habitatin dhe speciet e rrjedhës së poshtme.</p> <p>Për zbutjen e këtij ndikimi është i nevojshëm lëshimi i prurjes ekologjike (<math>Q_{\text{ekologjike}}</math>) e cila është llogaritur referuar ligjit 111/2012 “Per menaxhimin e integruar te ujerave”, neni 39, pika 2, sipas të cilit “Çdo përdorues i ujit është i detyruar që në rrjedhën natyrore të lejojë rrjedhjen minimale ekologjike, duke mos e përfshirë atë në sasinë e ujit që është i autorizuar të përdorë”.</p> <p>Kjo masë është shumë e rëndësishme sidomos gjatë muajve të thatë.</p> <p>Për të zbatuar këtë masë do të përgatitet një program MEWA ditor/javor/mujor duke u bazuar në të dhënat e matjeve të prurjeve ekzistuese.</p> <p>Hartimi dhe zbatimi i një plani monitorimi për sjelljen e faunës ujore në zonën e ndikuar është një masë që nevojitet për menaxhimin mjedisor të projektit.</p>

